

Newsletter

Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajve Shtator-Dhjetor ka marrë 46 vendime:

- **Marrëveshje të ndaluara:** 14 vendime;
- **Abuzim me pozitën dominuese:** 3 vendime;
- **Përqendrime:** 20 vendime;
- **Rekomandime:** 6 vendime;
- **Vendime të tjera:** 1 vendim;
- **Vendime me gjobë:** 2 vendime.



Ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim:

1 Abuzim me pozitën dominuese

Tregu i shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare

Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 952, datë 28.12.2022 vendosi:

- Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.
- Detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA të mos përdorë në asnjë rast elementët e mëposhtëm:

a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;

b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;

c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;

d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

- Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

2 **Marrëveshje e ndaluar** **Tregu i tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë**

Komisioni i Konkurrencës, me Vendim nr. 931, datë 16.12.2022, vendosi:

- Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të karburanteve naftë dhe benzinë.
- Ndërmarrjet që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë, kanë detyrimin ligjor të mos bëjnë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 1. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 2. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 3. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 4. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 5. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

3 **Përqendrim**

Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim njoftimin e përqendrimi të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK.


Duke qenë se shoqëria Riofarma SHPK nuk ka aktivitete dhe nuk është një konkurrent aktual në treg, efektet e koordinuara për të ndikuar në konkurrencën në treg, ka shumë pak gjasa të ndodhin në të ardhmen.

Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 923, datë 21.11.2022 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK.



Aktivitete



Në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës, mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive dhe përafrimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor me aquis të Bashkimit Evropian, Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi më datë 12 dhjetor, në ambientet e Maritim Hotel Plaza, aktivitetin me temë “Dita e Konkurrencës dhe prezantimi i ndryshimeve të propozuara në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ky aktivitet u çel me fjalën përshendetëse të kreut të Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba. Në vijim të aktivitetit z. Biba pati kënaqësinë të prezantonte për të ftuarit ndryshimet ligjore në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshime të cilat do të jenë pjesë e diskutimeve edhe në aktivitete të tjera të ngjashme ku aktorë të ndryshëm do të kenë mundësinë të shprehën në lidhje me to.

Takimi u përshëndet dhe nga Znj. Elisa Spiropali Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin e cila në fjalën e saj vlerësoi përpjekjet serioze për plotësimin e kuadrit ligjor në përputhje me aquis të BE, promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës në mbrojtje të ekonomisë së lirë dhe konsumatorit, si dhe nxitjen e bashkëveprimit me ekzekutivin dhe bashkëpunimit me institucionet homologe të Bashkimit Evropian me qëllim huazimin e praktikave më të mira në fushën e konkurrencës.

Aktivitetin e përshendetën dhe Znj. Reida Kashta, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik, Znj. Armela Krasniqi, Kryetare e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Z. Enio Jaço, President i Dhomës Amerikane të Tregtisë.

Në këtë aktivitet u diskutua për rëndësinë e forcimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive për mirëfunksionimin e tregut, si dhe të rolit të Autoritetit të Konkurrencës veçanërisht në çështje si prokurimet publike.



Në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës, mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe për të luftuar në mënyrë efektive marrëveshjet në oferta në procedurat e prokurimit publik, Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi sot, më datë 20 dhjetor, në ambientet e Rogner Hotel Tirana, tryezën e rrumbullakët me biznesin “Korniza legjislative për një rol më aktiv të Autoritetit të Konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”.

Në fjalën e tij Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba prezantoi për të ftuarit specifikat kryesore të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës, nevojën për një rol të ri akoma dhe më proaktiv të AK në funksion të kontrollit, zbulimit dhe ndëshkimit të marrëveshjeve të ndaluara në prokurimin publik, ndryshimet ligjore lidhur me marrëveshjet në oferta si dhe raste konkrete nga veprimtaria e Autoritetit lidhur me hetime të mëparëshme në tregun e prokurimeve publike.

Takimi u përshëndet nga Z. Eduard Shalsi, Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, i cili në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin e AK për mirëfunksionimin e tregut për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg për përmirësimin e procedurave të prokurimit publik.

Si pjesëmarrëse në këtë organizim Znj. Reida Kashta, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik në fjalën e saj prezantoi Udhërrëfyesin e Përbashkët, “Prokurimi Publik dhe Mbrojtja e Konkurrencës, Integriteti i Procesit të Prokurimeve Publike”, një material ky i hartuar me eksperiencën më të mirë të stafëve përkatëse i cili u nënshkrua nga Kryetari i AK, Z. Biba dhe Znj. Kashta, Drejtore e APP, për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, me synim identifikimin e mënyrave dhe mjeteve për të adresuar rastet e marrëveshjeve të ndaluara në ofertat publike, rritjen e ndërgjegjësimit për minimizimin e praktikave antikonkurrese të fshehta në tregjet e prokurimit, marrjen e nismave të përbashkëta për të përmirësuar njohuritë e përfaqësuesve të Autoriteteve Kontraktore etj.

Aktivitetin e përshendetën dhe Z. Jonaid Myzyri, Kryetar i Komisionit të Prokurimeve Publike dhe Z. Enio Jaço, President i Dhomës Amerikane të Tregtisë.